



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:022587

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02838883

P.nr.121/22

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm Penal - gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve M.B. nga Prizreni rr. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën para. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe Ibadete Begolli nga Prizreni rr. për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën parag. 3.2 lidhur me par.2 dhe me parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 të (KPRK)-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 47-4/22 të datës 08.02.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro, të akuzuarve nga Prizreni , me datën 21.03.2022, mori dhe shpalli ndërsa përpiloi me datën 23.03.2022 këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.M.B. nga i ati R. dhe e ëma R.e lindur S. i lindur me datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, **shqiptar**, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

2..I.B. nga i ati R. dhe e ëma R.e lindur S. e lindur me datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. ka të kryer shkollën e mesme, e divorcuar, nënë e një fëmije, e pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, **shqiptare**, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

JANË FAJTOR

I akuzuar M.B.

I. Me datë 04.01.2022, rrethe orës 17:45 minuta në Prizren rr. "Ernest Koliqi" respektivisht në shtëpinë tyre të përbashkët, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës motrës së tij- I.B. e cila është viktimë e ndjeshme për shkak të marrëdhënieve familjare që kanë mes veti, në atë mënyrë që ditën kritike pasi i pandehuri kthehet nga puna në shtëpi, vëren se ishte prishur modemi i internetit dhe e pyet të dëmtuarën se kush e ka prishur dhe në momentin kur e dëmtuar i thotë që ajo e ka prishur, i njëjti fillon që të fjaloset me të dhe me motrën tjetër dhe në një moment i afrohet të dëmtuarës, e kap për fyti dhe më pas e shtynë duke e rrëzuar për tokë, me ç'rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të fytyrës, të anës së përparme dhe të majtë të qafës si dhe të gjurit të këmbës së majtë, me besueshmëri të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mrehtë, i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, lëndime këto të konstatuara në akt ekspertimin mjeko-ligjor të lëshuar nga dr. V.K. më dt. 01.02.2022.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3.nën para.3.1 lidhur me para.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 41, 43. 44 para.1. ,47, 71, 72, dhe neni 365 të KPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

-Për veprën penale si në dispozitiv nën I./ të këtij aktgjykimit të akuzuarit i shqipton dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.

-Në kuptim të nenit 44. të KPK-së, me propozimin e të akuzuarit, **dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 200,00 (dyqind) euro**, i akuzuari dënimin me gjobë është i obliguar ta paguaj në katër këste mujore, duke filluar prej secilit këst nga çdo fillim i muajit 01-05 të muajit vijues, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

-Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë apo nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë gjykata mundë ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.

-I akuzuari M.B. **lirohet** në tërësi nga detyrimi për pagimin e shpenzimeve procedurale nga neni 450 par. 2 nën par. 2.1. deri në 2.6. dhe neni 453 par.4. të KPPRK-së dhe rrjedhimisht, shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate. Kjo për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të të akuzuarit, dhe se me pagesën e tij, do të rrezikohej seriozisht gjendja materiale e të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

E akuzuara I.B.

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pikën II./ të këtij dispozitivi, i shkakton lëndime trupore vëllait të saj – M.B. në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje momentale që kishin në mes veti lidhur me prishjen e modemit të internetit në mënyrën e përshkruar si më lartë, pasi i dëmtuari e kap për fyti dhe e shtyn të pandehurën duke e rrëzuar në tokë, në atë moment e pandehura e merr një mashë – mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtimit të shëndetit dhe me të njëjtën e godet M. në kokë, me ç'rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës, gërvishtje lëkurore të regjionit tëmtor të kokës dhe plagë qarëse – shqyese të indeve të buta të regjionit zverkor të kokës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë, i topitur) dhe si të tilla, një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, lëndime këto të konstatuara në akt ekspertimin mjeko-ligjor të lëshuar nga dr. V.K. me dt. 01.02.2022.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3.nën para.3.2 lidhur me para.2 dhe me para.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 41, 42, 46, 48, 49, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME BURGIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton:

-Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, brenda periudhës së verifikimit nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

-I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

-E akuzuara I.B. lirohet në tërësi nga detyrimi për pagimin e shpenzimeve procedurale nga neni 450 par. 2 nën par. 2.1. deri në 2.6. dhe nenit 453 par.4. të KPPRK-së dhe rrjedhimisht, shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate. Kjo për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të të akuzuarës, e njëjta është përfituese i ndihmës sociale dhe se me pagesën e saj, do të rrezikohet seriozisht gjendja materiale e të akuzuarës ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtuar aktakuzë nën numrin PP.nr. 47-4/22 të datës 08.02.2022, kundër të akuzuarve M.B. nga Prizreni rr. " Ernest Koliqi " nr.167/C për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën para. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe I.B. nga Prizreni rr. " Ernest Koliqi " nr.167/C, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën parag. 3.2 lidhur me par.2 dhe me parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 të (KPRK)-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 21.03.2022, është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, të akuzuarit M.B. dhe I.B. kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen duke shtuar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave. Dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarve meqenëse të njëjtin pranim të fajësisë sa i përket veprës penale e kanë bërë vullnetarisht, që është në pajtim me neni 248 të KPP-së.

I akuzuari M.B. deklaroi se: e pranon fajësinë vullnetarisht, jam penduar shumë për një veprim të tillë, kjo është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të dëmtuarën e kam motër, kemi raporte të mira familjare, kjo u vërejt edhe gjatë seancës, kemi pasur një zënkë verbale rrethe mos pajtimit të fjalëve është hera e parë dhe e pa qëllim të, jam i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes, jetojmë në një shtëpi së bashku me motrën time, premtoj dhe zotohem që më kurrë nuk do të përsërisë vepra të këtilla kundërligjore, jamë i gjendjes së dobët ekonomik materiale dhe e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

E akuzuara I.B. deklaroi se: e pranon fajësinë vullnetarisht, jam penduar shumë për një veprim të tillë, kjo është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të dëmtuarin e kam vëlla, kemi raporte të mira familjare, kjo u vërejt edhe gjatë seancës, kemi pasur një zënkë verbale rrethe mospajtimit të fjalëve është hera e parë dhe e pa qëllim të, jam e pa punë me ndihma sociale, e divorcuar me një fëmijë, mbajtëse e vetme e familjes, jetojmë në një shtëpi së bashku me vëllain tim, premtoj dhe zotohem që më kurrë nuk do të përsërisë vepra të tilla kundërligjore, jam e gjendjes së dobët ekonomik materiale dhe e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se të akuzuarit M.B. nga Prizreni rr. " Ernest Koliqi " nr.167/C e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën para. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe I.B. nga Prizreni rr. " Ernest Koliqi " nr.167/C, e ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën parag. 3.2 lidhur me par.2 dhe me parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 të (KPRK)-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I./ dhe II./ të këtij aktgjykimi.

Tiparet e veprës penale

Në nenin 185 paragrafi 3 nën parag. 3.1 lidhur me para.1 pika 1.4 të KP-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndim i lehtë trupor, e kryen "kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimi fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëri nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata ka vendosur që të akuzuarit M. B. dhe I.B. të shpallën fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës.

Rrethanat që janë marrë për bazë më rastin e shqiptimit të dënimit

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar se këto vepra penale paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore, dhe kohëve të fundit kjo dukuri është shtuar me të madhe, Ndërsa nga rrethanat lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë, keqardhja e shfaqur e të akuzuarve, deri te ky incident ka ardhur sepse kemi pasur një zënk verbale rrethe mospajtimit të fjalëve, është hera e parë dhe e pa qëllim të i kërkoj falje motrës sime, premtimi dhe zotimi se nuk do të kryej veprime të tilla kundërligjore, bashkëpunimi i përgjithshëm i personave të dënuar me gjykatën dhe sjellja e tyre pas ndodhjes së veprës, andaj në prani të këtyre rrethanave gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar si në dispozitivin I./ dhe II./ të këtij aktgjykimi do të arrihen qëllimet e dënimit, parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale e posaçërisht në rastin konkret është e rëndësishme të potencohet se do të arrij të evitohet në masë të madhe përhapjen e veprave penale të kësaj natyre.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil-juridik është marrë në pajtim me nenin 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. deri në 2.6. dhe nenit 453 par.4. të KPPRK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par. 3 pika 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit me nr.05/L-036.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2022:022587, 21.03.2022

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.